

AKT THEMELIMI

I Shoqerise me Pergjegjesi te Kufizuar “CIAO TAXI” sh.p.k

Ne Tirane, sot me date 31 Totor , ne cilesine e “ortakut themelues “:

Z. Altin Metaliaj, i dtl. 29/06/1987, lindur ne Bajram Curri, i biri i Zmajl dhe Bukurie Metaliaj, banues ne Shqiperi, Rruga Muzaket, Pallati 28, Shk.5, Tirane, madhor, me zotesi jurdike dhe per te vepruar, mbajtes i karte me nr.I70629083F.

I cili ne cilesine e “ortakut themelues “, me vullnet të lire, të plote e të sinqerte, harton kete akt themelimi per krijimin e shoqerise me pergjegjesi te kufizuar me emertimin “ CIAO TAXI “ shpk mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikes se Shqiperise dhe Kodin Civil ne fuqi, ne ligjin 9901 date 14.04.2008, “ Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare “ te ndryshuar me ligjin 129/2014, ne ligjin 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”, ne Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor.

KREU I

Neni 1
Krijimi

Shoqeria “ CIAO TAXI “ shpk, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”). **Emri tregtar i shoqerise “ CIAO TAXI ”**

Neni 2
Personaliteti juridik

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në QKB, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria “CIAO TAXI “ shpk, është një shoqëri tregtare, e themeluar nga “ortaku i shoqerise”, i cili nuk përgjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulojne personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë. Ortaku gjëzon kuotën e tij në shoqëri, në përpjesëtim me kontributin që ka dhënë në kapital.

Neni 3
Selia

Shoqeria e ka seline kryesore ne : Rruga Muzaket, Pallati 28, Shk.5, Tirane. Shoqeria mund te ndryshoje seline e tij, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijoje filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikes se Shqiperise, vetëm me vendim te Ortakut te Shoqerise.

Neni 4
Objekti i veprimtarise

Ofrimi i sherbimeve taksi, blerja, shitja, marrja dhe dhenia me qira, importimi i automjeteve dhe mjetave te transportit.

Neni 5
Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij per një periudhe kohore te papercaktuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

KREU II KAPITALI

Neni 6 Kapitali themeltar

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 10,000 lek.

Kapitali i mesiperm eshte nënshkruar dhe do te shlyhet apo te hapen llogarite bankare te shoqerise teresisht ne te holla nga “ortaku i shoqerise” i shoqerise :

Z. Altin Metaliaj, eshte zoteruese e 1 kuote me vlore 10,000 Lek, e cila perfaqeson 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Kontributi i ortakut mund te jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta) Ortaku per gjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontributit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise.

Neni 7 Zmadhimi dhe zvogelimi i kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit te nje eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre.

Kapitali i regjistruar i shoqërisë mund te zvogëlohet me vendim të Asamblese se Ortakut se shoqerise në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.

Vendimi për zvogëlimin e kapitalit i njoftohet Qendrës Kombëtare të Regjistrimit për regjistrim nga Administratori, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”.

Neni 8 Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet te bëhet me shkrim.

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit te tij ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

KREU III ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

Neni 9 Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakut eshte organi i vetem vendimmarres i shoqerise.

Asambleja e Ortakut eshte organi vendimmarres i shoqerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne ligj. Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqyruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Asambleja e Ortakut, vendos për çështje si :

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e Administratoriёve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga Administratoriët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj Administratoriёve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Të gjitha vendimet e marra nga ortaku i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen. Duhen regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:
- a) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - b) shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
 - c) investime;
 - ç) vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme. Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmérinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria provon se i treti ka pasur dijeni për pavlefshmérinë, apo në bazë të rr Ethanave të qarta nuk mund të mos kishte pasur dijeni për të.

Neni 10

Administrimi

Administratori i shoqerise eshte: **Z. Altin Metaliaj.**

Administratori i shoqerise do te ushtroje kompetencat e administrimit per nje afat 5 vjecar me te drejte riperteritje.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asambleja e Ortakut te shoqerise. Administrator i shoqerise mund te emerohet edhe nje person i trete jashte ortakerise.

Neni 11

Kompetencat

Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshem dhe te jashtezakonshem te veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga Asambleja e Ortakut;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- ç) përgatisë dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë Asambleja e Ortakut për miratim;
- d) krijojë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rr Ethanat, që kërcenojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- e) raportojë përparrë asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasë mbledhjen e Asambleja e Ortakut edhe ne rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë

nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të tij, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 pér qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratorii ka të drejte të kryeje të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratorii përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, Bankave te te gjitha niveleve, zyrate te tatim taksave, autoriteteve doganore, përfshi këtu edhe autoritetet gjyqësore të gjitha shkallev. Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e tij.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i

Administratoreve e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoronin këtë akt në rr Ethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaf tueshme.

Neni 12

Pergjegjesite

Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga Asambleja e Ortakut që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen Administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", Administratori detyrohet:

1. a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërësi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdus;
b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
ç) të parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.

2. Administratori, gjatë kryerjes së detyras së tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.

3. Nëse Administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standarde profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij nenit, eshte i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një Administratori, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.

4. Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, Administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërbuje shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare“, kryen veprimet e mëposhtme:

- a) u kthen ortakëve kontributet;
 - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
 - c) u shpërndan aktivet shoqërisë;
- ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikojë që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
- d) jep kredi.

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbylljet me 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqerise dhe dividentet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit finanziar, Mbledhja e Asambleja e Ortakut, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Asambleja e Ortakut vendos rreth shperndarjes se dividentit, pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem finanziar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Baza Ligjore

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e tij ne perputhje te plete me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptare.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republiken e Shqiperise.

Neni 16

Dispozita perfundimtare

Ky Akt themelimi i shoqerise "CIAO TAXI" shpk, u redaktua me vullnetin te lire e te plete te "ortakut themelues", ne 2 ekzemplare me vlera te njejtë juridike ne gjuhen shqipe.

ORTAKU I SHOQERISE

Altin Metaliaj

